R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA LUSHNJE

Lushnje, më___.___.2026

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE
PËR PRANIMIN NË POZICIONIN DREJTOR,DREJTORIA E POLICISË BASHKIAKE
BASHKIA LUSHNJE

Në zbatim të Ligjit nr. nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", LigjI Nr. 89/2022 „Për Policinë Bashkiake",nenet 12 dhe 24,Bashkia Lushnje njofton se shpallet (një) vend i lirë pune në **pozicionin Drejtor, Drejtoria e Policisë Bashkiake.**

-Misioni: Policia Bashkiake ka si mision ushtrimin e funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.

-Drejtuesi i Policisë Bashkiake është autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe organizativ i Policisë Bashkiake, që përgjigjet drejtpërdrejt para kryetarit të bashkisë për realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuar.

Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtuesit të Policisë Bashkiake
Drejtuesi i Policisë Bashkiake ushtron këto përgjegjësi dhe detyra: a) organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrimeve dhe kompetencave që ka Policia Bashkiake; b) koordinon veprimtarinë e punës me Policinë e Shtetit për zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e rendit e të sigurisë publike në parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë; c) planifikon aktivitetin në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë të objektivave të përcaktuar; ç) kryen analiza, raporte, përshkrime që lidhen me veprimtarinë e Policisë Bashkiake; d) i propozon kryetarit të bashkisë kalendarin e trajnimeve për të siguruar kualifikimin periodik profesional të punonjësve të Policisë Bashkiake; dh) këshillon kryetarin e bashkisë dhe jep mendime për zgjidhjen e çështjeve në fushën e përgjegjësisë së tij.

Kriteret për pranimin në Policinë Bashkiake të çdo personi janë si më poshtë:
a) të jetë shtetas shqiptar;
b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;

d) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
e) të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
ë) të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

Kriteret për emërimin e drejtuesit të Policisë Bashkiake

1. Kandidati për drejtues të Policisë Bashkiake, përveç kritereve të përcaktuara në nenin 12 të ligjit 89/2022 :Për policinë Bashkiake“ , plotëson edhe kriteret e mëposhtme:
a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë ose të ketë diplomë të barasvlershme me të ose të ketë përfunduar studimet e arsimit të lartë jashtë vendit dhe të ketë njohur dhe njësuar diplomën sipas përcaktimeve për njësimin e diplomave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë, në shkenca shoqërore, juridike, ekonomike ose institucionet arsimore të sigurisë;
b) të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;
c) të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

2. Procedura e përzgjedhjes për drejtuesin e Policisë Bashkiake përfshin fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve, testimin me shkrim dhe intervistën nga komisioni përzgjedhës.

3. Emërimi i drejtuesit të Policisë Bashkiake bëhet nga kryetari i bashkisë sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

Kandidatët duhet te dërgojë me postë ose dorazi në zyrën e Protokollit, Drejtoria e Burimeve Njerezore dokumentacionin e kërkuar deri në daten **29.05.2026**

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE